



# Mane TCI Shpk

---

Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor 2016

INDIVIDUALE

## RAPORT I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për: "BALFIN" Shpk,

Ortak i vetëm i shoqërisë "MANETCI" shpk

NUIS-K22203004A

Njesia Bashkiake Nr.2, Rr. "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, kati 8, Ap.nr.3 dhe 4,  
Tiranë

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare "MANETCI" shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2016, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit në vijim, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi i shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRFtë, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

#### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të bazuara në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

Ne gjithashtu:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse të shoqërisë, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

Auditues i pavarur  
EKR. Vjollca Dervishi



Rr. Frederik Shiroka, Pall.1, Shk 3, Ap 5, Tirane

Auditues i pavarur  
EKR. Klodiana Bllaci



Rr. Jordan Misja, pallati 147, Aa. 3, Tirane

Tiranë, më 31 Mars 2017

## PËRMBAJTJA

1.	PASQYRA E SITUATËS FINANCIARE .....	1
2.	PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE.....	3
3.	PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE .....	4
4.	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	5
5.	INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....	6
6.	BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE.....	6
7.	NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHPJEGIMET.....	6
8.	GJYKIMET, VLERËSIMET DHE SUPOZIMET KONTABËL TË RËNDËSISHME .....	7
9.	POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL .....	8
10.	AKSIONE DHE PJESËMARRJE TË TJERA NË NJËSITË E KONTROLLUARA.....	13
11.	LLOGARI /KËRKESA TË ARKËTUESHME AFATGJATA.....	13
12.	AKTIVE AFATGJATA MATERIALE (AAM).....	13
13.	KAPITALI AKSIONER.....	14
14.	MJETE MONETARE.....	14
15.	AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTRA.....	14
16.	INVENTARI .....	15
17.	PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA .....	16
18.	HUATË AFATGJATA.....	16
19.	HUAMARRJE TË TJERA AFATGJATA.....	16
20.	GRANTE DHE TË ARDHURAT E SHTYRA .....	16
21.	HUAMARRJET AFATSHKURTRA .....	17
22.	HUATË DHE PARAPAGIMET.....	17
23.	GRANTET DHE TË ARDHURAT E SHTYRA.....	18
24.	REZERVA LIGJORE.....	18
25.	REZERVA TË TJERA .....	18
26.	SHITJET NETO.....	18
27.	TË ARDHURA TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT .....	19
28.	MALLRA, LËNDËT E PARA DHE SHËRBIMET .....	19
29.	SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT .....	19
30.	SHPENZIME TË PERSONELIT.....	20
31.	TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA INTERESI.....	20
32.	SHPENZIMET E TATIMIT MBI FITIMIN.....	20
33.	TE ARDHURA DHE SHPENZIME NGA NJESITE E KONTROLLUARA.....	21
34.	PALËT E LIDHURA - BILANCI KONTABËL 31 DHJETOR 2016.....	22
35.	PALËT E LIDHURA – FITIM/HUMBJA - VITI 2016.....	23
36.	NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT .....	24
37.	PARIMI I VIJIMESISE.....	24



(Vlerat janë të shprehura në Lekë)

1. PASQYRA E SITUATËS FINANCIARE

A	AKTIVET	Shenime	Viti Ushtrimor Dhjetor 2016	Viti Ushtrimor Dhjetor 2015
<b>I</b>	<b>Aktivet Afatgjata</b>			
<b>1</b>	<b>Investimet financiare afatgjata</b>	<b>10</b>		
a)	Aksione dhe pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara (vetëm për pasqyrat financiare të pakonsoliduara)		4,050,925,475	4,067,766,753
b)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje			
c)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë			
d)	Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjata	11	228,662,328	323,708,084
	<b>Totali</b>		<b>4,279,587,803</b>	<b>4,391,474,837</b>
<b>2</b>	<b>Aktive afatgjata materiale</b>	<b>12</b>		
a)	Toka			-
b)	Ndertesa (minus amortizimi)		92,550,939	51,326,449
c)	Makineri dhe pajisje (minus amortizimi)		32,671,769	35,241,639
d)	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vlerë kontabel)		101,883,928	70,023,201
	<b>Totali</b>		<b>227,106,636</b>	<b>156,591,289</b>
<b>3</b>	<b>Aktive biologjike afatgjata</b>			-
<b>4</b>	<b>Aktivet afatgjata jomateriale</b>			-
a)	Emri i mirë			-
b)	Shpenzimet e zhvillimit			-
c)	Aktive të tjera afatgjata jomateriale			-
	<b>Totali</b>			-
<b>5</b>	<b>Kapitali aksionar i papaguar</b>			
<b>6</b>	<b>Aktive të tjera afatgjata (në proces)</b>			
	<b>TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA</b>		<b>4,506,694,439</b>	<b>4,548,066,126</b>
<b>II</b>	<b>Aktivet Afatshkurtra</b>			
<b>1</b>	<b>Mjete monetare</b>	<b>14</b>	108,635,782	204,741,998
<b>2</b>	<b>Dervativë dhe aktive financiare të mbajtura për tregtim</b>			
a)	Derivatvët			
b)	Aktivet e mbajtura për tregtim			
	<b>Totali</b>		<b>108,635,782</b>	<b>204,741,998</b>
<b>3</b>	<b>Aktive të tjera financiare afatshkurtra</b>	<b>15</b>		
a)	Te arkëtueshme nga kliente		643,297,821	720,155,859
b)	Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme		273,136,392	336,231,496
c)	Aktive tatimore të shtyra		13,046,312	17,090,763
d)	Instrumente të tjera borxhi		2,028,450	4,804,800
e)	Investime të tjera financiare			
	<b>Totali</b>		<b>931,508,975</b>	<b>1,078,282,918</b>
<b>4</b>	<b>Inventari</b>	<b>16</b>		
a)	Lëndët e para		53,073,619	50,741,562
b)	Punime në proces		1,175,053,231	617,741,124
c)	Produkte të gatshme (provizore për zhvleresime -)		3,103,818,944	4,939,313,259
d)	Mallra për rishitje		-	-
e)	Parapagesa për furnizime		-	-
	<b>Totali</b>		<b>4,331,945,794</b>	<b>5,607,795,944</b>
<b>5</b>	<b>Aktivet biologjike afatshkurtra</b>			
<b>6</b>	<b>Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje</b>			
<b>7</b>	<b>Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra</b>	<b>17</b>	1,326,908	2,771,300
	<b>AKTIVET TOTALE AFATSHKURTRA</b>		<b>5,373,417,459</b>	<b>6,893,592,161</b>
	<b>TOTALI AKTIVEVE</b>		<b>9,880,111,898</b>	<b>11,441,658,287</b>

**MANE TCI SH.P.K**  
**31 Dhjetor 2016**

(Vlerat janë të shprehura në Lekë)

	Zëri i Bilancit	Shenime	Viti Ushtrimor Dhjetor 2016	Viti Ushtrimor Dhjetor 2015
<b>B</b>	<b>PASIVET DHE KAPITALI</b>			
<b>I</b>	<b>Pasivet Afatgjata</b>			
<b>1</b>	<b>Huat afatgjata</b>			
a)	Hua , bono dhe detyrime nga qeraja financiare	18	377,359,642	122,948,291
b)	Bonot e konvertueshme		-	-
	<i>Totali</i>		377,359,642	122,948,291
<b>2</b>	<b>Huamarrje të tjera afatgjata</b>	19	285,666,941	1,016,223,885
<b>3</b>	<b>Provizionet afatgjata</b>		-	-
<b>4</b>	<b>Grandet dhe të ardhurat të shtyra</b>	20	2,132,813,846	3,092,829,033
	<b>TOTALI I PASIVEVE AFATGJATA</b>		<b>2,795,840,429</b>	<b>4,232,001,209</b>
<b>I</b>	<b>Pasivet Afatshkurtra</b>			
<b>1</b>	<b>Dervativët</b>			
<b>2</b>	<b>Huamarrjet</b>	19	1,546,897,701	2,107,765,969
a)	Huat dhe obligacionet afatshkurtra	21	783,250,253	1,143,129,340
b)	Kthimet / ripagesat e huave afatgjata		763,647,447	964,636,629
c)	Bono të konvertueshme			
	<i>Totali</i>		1,546,897,701	2,107,765,969
<b>3</b>	<b>Huat dhe parapagimet</b>			
a)	Te pagueshme ndaj furnitorëve	22	1,061,244,189	1,210,652,564
b)	Te pagueshme ndaj punonjësve		-	208,773
c)	Detyrimet tatimore		100,433,062	20,694,247
d)	Hua të tjera		999,736	-
e)	Parapagimet e arkëtuara		87,530,751	79,146,540
	<i>Totali</i>		1,250,207,738	1,310,702,123
<b>4</b>	<b>Grandet dhe të ardhurat e shtyra</b>	23	1,862,561	3,013,441
<b>5</b>	<b>Provizionet afatshkurtra</b>			-
	<b>TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA</b>		<b>2,798,967,999</b>	<b>3,421,481,533</b>
	<b>TOTALI I PASIVEVE</b>		<b>5,594,808,428</b>	<b>7,653,482,742</b>
<b>III</b>	<b>Kapitali</b>			
<b>1</b>	<b>Aksionet e pakicës (vetem per pasq.fin.të konsoliduara)</b>			-
<b>2</b>	<b>Kapitali që i përket aksionerëve të shoqërisë mëmë (vetem per pasq.fin.të konsoliduara)</b>			-
<b>3</b>	<b>Kapitali aksionar</b>	13	689,750,000	689,750,000
<b>4</b>	<b>Primi i aksionit</b>			-
<b>5</b>	<b>Njësitet ose aksionet e thesarit ( negative)</b>			-
<b>6</b>	<b>Rezerva statusore</b>			-
<b>7</b>	<b>Rezerva ligjore</b>	24	756,000	756,000
<b>8</b>	<b>Rezerva të tjera</b>	25	2,596,073,919	2,596,073,919
<b>9</b>	<b>Fitimet e pashpërndara</b>		-	213,764,194
<b>10</b>	<b>Fitimi (humbja) e vitit financiar</b>		998,723,552	287,831,433
	<b>TOTALI I KAPITALIT</b>		<b>4,285,303,471</b>	<b>3,788,175,545</b>
	<b>TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>9,880,111,897</b>	<b>11,441,658,287</b>



(Vlerat janë të shprehura në Lekë)

2. PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE

PËRSHKRIMI	Shenime	Viti Ushtrimor Dhjetor 2016	Viti Ushtrimor Dhjetor 2015
Shitjet neto	26	1,911,740,700	1,633,472,073
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë shfrytëzimit	27	4,151,773	3,061,308
<b>Totali I te ardhurave</b>		<b>1,915,892,473</b>	<b>1,636,533,381</b>
Kostoja e mallrave dhe shërbime të shitura	28	(846,563,405)	(1,174,511,516)
<b>Fitimi (humbja) bruto</b>		<b>1,069,329,068</b>	<b>462,021,865</b>
Kostot e shpërndarjes		-	-
Shërbime	29	(38,890,719)	(17,789,886)
Tatim taksa	29	(2,685,417)	(4,294,040)
Te tjera shpenzime operative	29	(31,598,601)	(19,989,663)
Shpenzime të personelit	30	(111,873,511)	(97,052,927)
Rënia në vlerë (zhvlerësimi) dhe amortizimi		(34,075,984)	(29,371,339)
<b>Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>850,204,836</b>	<b>293,524,010</b>
Të ardhura dhe shpenzime financiare nga njesitë e kontrolluara	33	264,447,546	
Të ardhura dhe shpenzime nga investime në sipërmanje			
<i>Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata</i>			
<i>Të ardhurat dhe shpenzimet Financiare neto</i>	31	<i>(2,781,833)</i>	<i>6,735,422</i>
<i>Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit</i>	31	<i>20,081,735</i>	<i>29,150,179</i>
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>		<b>281,747,448</b>	<b>35,885,600</b>
<b>Fitimi (humbja) para tatimit</b>		<b>1,131,952,284</b>	<b>329,409,611</b>
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 15 %	32	(133,228,731)	(41,578,178)
<b>Fitimi (humbja) neto e vitit financiar</b>		<b>998,723,552</b>	<b>287,831,433</b>
Te tjera te ardhura gjithëpërfshirëse			
<b>Totali i Humbjeve gjithëpërfshirëse</b>		<b>998,723,552</b>	<b>287,831,433</b>

Këto pasqyra financiare, dhe shënimet shoqëruese 1 deri në 24, janë pjesë e rëndësishme e këtyre pasqyrave financiare:


Arben MEMO  
Administratori

Arben Memo



Vjola KAMBELLARI  
Drejtori i Departamentit të Financës

Vjola Kambellari



(Vlerat janë të shprehura në Lekë)

3. PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

		Shenime	Viti Ushtimor Dhjetor 2016	Viti Ushtimor Dhjetor 2015
<b>A</b>	<b>Fluksi parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
1	Fitimi para tatimit		1,131,952,284	329,409,611
	Rregullimet për :			
2	Amortizimin		34,075,984	28,920,790
3	Të ardhura nga investimet			
4	Të ardhura nga interesat		(24,087,628)	(40,166,113)
5	Shpenzime për interesa		25,012,881	30,427,977
6	(Rritje) / rënie në tepricën e kërkesave të arketueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arketueshme të tjera		327,066,240	12,312,654
7	(Rritje) / rënie në tepricën e inventarit		1,277,294,543	35,538,042
8	(Rritje) / rënie në tepricën detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti		(146,891,806)	(165,111,943)
9	Paratë e perfuara nga aktivitetet			
10	Interesi i arkëtuar / (paguar)		(25,012,881)	(30,427,977)
11	Tatim fitimi i paguar		(133,228,731)	(41,578,178)
	<b>Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		<b>2,466,180,885</b>	<b>159,324,863</b>
<b>B</b>	<b>Fluksi i parave nga veprimtaritë e investuese</b>			
1	Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		16,841,278	(1,110,523,000)
2	Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(104,591,331)	1,333,164,339
3	Të ardhura nga shitja e paisjeve			
4	Interesi i arkëtuar		24,087,628	40,166,113
5	Dividendët e arkëtuar		(501,595,626)	
	<b>Paraja neto, e perdorur në aktivitetet e investuese</b>		<b>(565,258,051)</b>	<b>262,807,452</b>
<b>C</b>	<b>Fluksi i parave nga veprimtaritë e financiare- Cash flows from financing activities</b>			
1	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		264,447,544	-
2	Te ardhura nga huamarrje			
3	Pagesat e detyrimeve të huave / qirasë financiare		(2,261,476,592)	(259,470,329)
4	Dividendët të paguar		-	
	<b>Para neto e perdorur në aktivitetet financiare</b>		<b>(1,997,029,048)</b>	<b>(259,470,329)</b>
	<b>Rritja / (renia) neto e mjeteve monetare</b>		<b>(96,106,215)</b>	<b>162,661,986.78</b>
	<b>Mjete monetare në fillim të periudhës kontabel</b>		<b>204,741,998</b>	<b>41,629,463</b>
	<b>Mjete monetare në fund të periudhës kontabel</b>	9	<b>108,635,784</b>	<b>204,741,999</b>





MANE TCI SH.P.K.  
31 Dhjetor 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë)

4. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

PËRSHKRIMI	Kapitali i nëshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutor e	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	në lekë		
									Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2014	689,750,000	-	-	756,000	-	2,568,907,899	-	240,479,665	3,499,893,564		3,499,893,564
Efektet e ndryshimeve në politikat kontabël	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar i ridekluarur më 1 janar 2015	689,750,000	-	-	756,000	-	2,568,907,899	-	240,479,665	3,499,893,564	-	3,499,893,564
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											
Fitimi / Humbja e vitit			(213,313,646)				213,764,194	287,831,433	287,831,433		287,831,433
Caktimi i fitimit të pashpërndarë									450,548		450,548
Pozicioni financiar i ridekluarur më 31 Dhjetor 2015	689,750,000	-	-	756,000	-	2,596,073,918	213,764,194	287,831,433	3,788,175,544		3,788,175,544
Pozicioni financiar i ridekluarur më 1 janar 2016	689,750,000	-	-	756,000	-	2,596,073,918	213,764,194	287,831,433	3,788,175,544		3,788,175,544
Fitimi / Humbja e vitit								998,723,552	998,723,552		998,723,552
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											
Caktimi i fitimit të pashpërndarë							(213,764,194)	(287,831,433)	(501,595,626)		(501,595,626)
Pozicioni financiar i ridekluarur më 31 dhjetor 2016	689,750,000	-	-	756,000	-	2,596,073,918	-	998,723,552	4,285,303,470	-	4,285,303,470
Pozicioni financiar i ridekluarur më 1 janar 2017	689,750,000	-	-	756,000	-	2,596,073,918	-	998,723,552	4,285,303,470	-	4,285,303,470



*(Vlerat janë të shprehura në Lekë)*

## **5. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

Shoqëria "MANE TCI" Sh.p.k. është krijuar më datë 25 Prill 2002 me Vendim të Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë me Nr. 27647 dhe është regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në të njëjtën ditë, me kapital të nënshkruar prej 500.000 lekë, i cili është rritur në vite dhe më 31.12.2016 është 689,750,000 lekë.

Deri në Janar të vitit 2009 ortak i vetëm i shoqërisë ka qenë Z. Samir Mane. Më pas, kuotat e kapitalit i kaluan shoqërisë BALFIN Shpk me NIPT K72223031K me ortak të vetëm Z. Samir Mane.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: Ndërtimi, investimi në prona të paluajtshme, qeradhënia, tregtimi i mallrave me shumice e pakicë, import-eksport, etj, sipas objektit të veprimtarisë të përcaktuar në vendimin e gjykatës Tiranë.

Selia e shoqërisë ndodhet në Njesia Bashkiake Nr.2, Rr. "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, kati 8, Ap.nr.3 dhe 4 në Tiranë.

Administrator i shoqërisë është Z. Arben MEMO. Numri mesatar i punonjësve më 31 Dhjetor 2016 ishte 116 krahasuar me 110 që ishte më 31.12.2015.

## **6. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("IFRS"), të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël ("IASB").

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik, ku operon shoqëria. Shifrat janë të rrumbullakosura në Lekë.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare janë të kompensuara me njëra tjetrën dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejte ligjore për t'i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përpjekje për t'i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompesuara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standart i kontabilitetit ose interpretimit, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

## **7. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHPJEGIMET**

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me politikat e vitit të mëparshëm me përjashtim të SNRF-ve të ndryshuara, të cilat janë adoptuar nga Shoqëria në datën 1 janar 2014.

- **SNK 32 Instrumentet Financiare, Paraqitja (Ndryshuar) – Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare**
- **SNK 39 Instrumentet financiare (Ndryshuar): Njohja dhe Matja - Zëvendësimi i Derivativeve dhe Vijimësia i Kontabilitetit Mbrojtës**
- **SNK 36 Zhvlerësimi Aktiveve (Ndryshuar) – Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Shumat e Rikuperueshme të Aktiveve jo – Financiare**
- **KIRFN Interpretimi 21: Taksat**

Në rast kur konsiderohet se adoptimi i standardit apo interpretimit të tij ndikon tek pasqyrat financiare apo tek performanca e Shoqërisë, ndikimi i saj përshkruhet si vijon:

- **SNK 32 Instrumentet Financiare, Paraqitja (Ndryshuar) – Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare**

Këto ndryshime sqarojnë kuptimin "aktualisht ka një të drejtë të zbatueshme ligjore për kompensim". Ndryshimet sqarojnë gjithashtu zbatimin e SNK 32 Kriteret e Kompensimit për Sistemet e Shlyerjes (si për shembull sistemet e institucioneve qëndrore kleringu), të cilët zbatojnë mekanizma të shlyerjes bruto, të cilat nuk janë të njëpasnjëshme. Nuk ka asnjë efekt në pasqyrat financiare të shoqërisë nga aplikimi i ndryshimeve të mësipërme.

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë)*

➤ **SNK 39 Instrumentet Financiare (Ndryshuar): Njohja dhe Matja - Zëvendësimi i Derivativeve dhe Vijimësia i Kontabilitetit Mbrojtës**

Ndryshimi parashikon se nuk do të ishte e nevojshme që të skontohej kontabiliteti mbrojtjes nëse një derivativ mbrojtje zëvendësohet, me kusht që të plotësohen disa kritere. Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) ka bërë një ndryshim të ngushtë objektit të SNK 39, për të lejuar vazhdimin e kontabilitetit mbrojtjes në disa rrethana të caktuara ku pala tjetër e instrumentit mbrojtjes ndryshon, në mënyrë për të arritur likuidimin për atë instrument. Nuk ka asnjë efekt në pasqyrat financiare të shoqërisë nga aplikimi i ndryshimeve të mësipërme.

➤ **SNK 36 Zhvlerësimi Aktiveve (Ndryshuar) – Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Shumat e Rikuperueshme të Aktiveve Jo – Financiare**

Këto ndryshime heqin pasojat e paqëllimshme të SNRF 13 mbi dhënien e informacioneve shpjeguese, që kërkohen sipas SNK 36. Përveç kësaj, këto ndryshime kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese të shumave të rikuperueshme për aktivet apo Njësitë Gjeneruese të Mjeteve Monetare (CGUs), për të cilën zhvlerësimi është njohur apo është rimarrë gjatë periudhës. Nuk ka asnjë efekt në pasqyrat financiare të shoqërisë nga aplikimi i ndryshimeve të mësipërme.

➤ **KIRFN Interpretimi 21: TAKSA**

Komitetit të Interpretimeve i është kërkuar të marrë në konsideratë se si një entitet duhet të përgjigjet për detyrimet për të paguar taksat e vendosura nga qeveritë, përveç taksat mbi të ardhurat, në pasqyrat e saj financiare. Ky Interpretim është një interpretim i SNK 37 Provizionet, Pasivët dhe Aktivët e Kushtëzuara. SNK 37 përcakton kriteret për njohjen e një pasivi, një prej të cilave është kërkesa që entiteti të ketë një detyrim aktual, si rezultat i një ngjarjeje të mëparshme (e njohur si një ngjarje detyruese). Interpretimi sqaron se ngjarja detyruese që shkakton një detyrim për të paguar një taksë është aktiviteti i përshkruar në legjislacionin përkatës që shkakton pagesën e taksës. Nuk ka asnjë efekt në pasqyrat financiare të shoqërisë nga aplikimi i ndryshimeve të mësipërme.

## **8. GJYKIMET, VLERËSIMET DHE SUPOZIMET KONTABËL TË RËNDËSISHME**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon gjykime dhe vlerësime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara nga shoqëria.

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar vazhdimisht. Ndryshime në cmuarjet dhe vlerësimet kontabile njihen në periudhën në të cilën cmuarjet ndryshojnë, dhe në periudhat e ardhshme që mund të preken nga ky ndryshim. Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë.

### ***Përcaktimi i vlerës së drejtë***

Politikat kontabël të miratuara nga shoqëria nuk kërkojnë patjetër përcaktimin e vlerës së drejtë qoftë për aktivet dhe pasivët financiarë dhe për ato jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime informimi bazuar në metodat e mëposhtme. Aty ku është e aplikueshme, jepet informacion i mëtejshëm i detajuar mbi supozimet e bëra gjatë përcaktimit të vlerave të drejta te shpalosura në shënimet specifike për aktivin ose detyrimin.

### ***Tatimi mbi fitimin***

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njeh detyrimin në rast të auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë)*

taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jetë i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

Aktiviteti i shtyrë njihet për humbjet tatimore të papërdorura deri në atë masë që është e mundshme që do të ketë fitim të tatueshëm, do të jetë i disponueshëm dhe kundrejt të cilit mund të shfrytëzohen humbjet. Është i nevojshëm gjykim nga menaxhimi për të përcaktuar shumën e aktiveve tatimore të shtyra që mund të njihen, bazuar mbi kohën e mundshme dhe nivelin e fitimit të tatueshëm të pritshëm, së bashku me strategjitë për planifikimin tatimor.

**Rishikimi i zhvlerësimit**

Rikuperimi i aktiveve është një çështje që kërkon gjykim të menaxhimit, që kërkon vlerësim nëse vlera kontabël e aktiveve mund të mbështetet në vlerën neto aktuale të flukseve monetare të ardhshme që pritet të gjenerohen nga përdorimi i aktiveve të tilla duke përdorur parashikimet e flukseve monetare të cilat janë skontuar me një normë të përshtatshme. Në llogaritjen e vlerës aktuale neto të flukseve monetare të ardhshme, janë të nevojshme supozime në lidhje me çështjet të pasigurta, siç përmendet më poshtë.

Standartet IFRS kërkojnë që menaxhimi të kryejë teste vjetore për zhvlerësimin e aktiveve dhe përcaktimin e jetës së tyre, gjithashtu kërkohet dhe vlerësimi i situatave të mundshme që do të sillnin mosrikuperimin e vlerës së aktiveve. Bazuar në informacionin e disponueshëm dhe testimet, shoqëria ka arritur në përfundimin se nuk ka indikacione për zhvlerësim të aktiveve në 31 Dhjetor 2016.

## **9. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL**

Politikat kontabël të përkrahura më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në pasqyrat financiare dhe janë zbatuar në mënyrë konsistente nga shoqëria.

### **(a) Transaksionet në monedhë të huaj**

Regjistrimet kontabël të shoqërisë janë paraqitur në monedhën vendase "Lek", e cila është monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë tjetër nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit që është kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2016, 1 Euro me 135.23 Lekë dhe 1 USD me 128.17 Lekë. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë rregjistrohen në monedhë të huaj dhe rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodhin, duke përjashtuar diferencat nga këmbimi në huamarrjen në monedhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim, për përdorim frytëdhënës në të ardhmen, të cilat janë përfshirë në kostot e aktiveve si një rregullim të koston të interesit në huamarrjen në monedhë të huaj.

### **(b) Instrumentat financiarë**

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha të drejtat e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur Shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç'regjistron një aktiv në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset e të ardhurave skadojnë, ose kur të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave transferohen me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe risqet që lidhen me pronësinë e aktivit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara, paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim.

Një detyrim financiar ç'regjistrohet kur detyrimi shlyhet, mbyllet ose përfundon afati i tij. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet me kushte të ndryshme nga një tjetër po nga i njëjti kontraktor ose kushtet e detyrimit ekzistues modifikohen ndjeshëm, atëherë ai do të trajtohet si ç'regjistrim i detyrimit aktual dhe njihes së një detyrimi të ri. Diferenca nga kryerja e transaksionit do të njihen në pasqyrën e të ardhurave.

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë)*

Detyrimet dhe të drejtat financiare netohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të netuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat jo derivativë të Shoqërisë përfshijnë të tregëtueshmet dhe llogaritë e arkëtueshme, para ja dhe ekuivalentët e saj, të tregëtueshmet dhe llogaritë e pagueshme të tjera.

*Mjetet monetare dhe ekuivalentët të saj*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj përfshijnë paratë ne arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet tre mujor ose më pak. Për qëllime të përgatitjes së pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga para ja dhe depozitat afatshkurtra të përcaktuara me lart, pasi zbritet teprica e paradhënive bankare.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi.

*Huamarrjet dhe parapagimet*

Huatë e marra nga institucionet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektív, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektív.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë llogaritje për koston e amortizuar të një detyrimi financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skonton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

*Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

*Të tjera*

Instrumenta të tjerë financiarë jo-derivativ vlerësohen me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektív minus humbjet nga zhvlerësimi.

*Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital

**(c) Aktive afatgjata të investimit**

Aktivet afatgjata të investimit, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qeratë dhe/ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë edhe prona për ndërtim për qëllime të tilla), vlerësohen fillimisht me kosto duke përfshirë edhe kostot e transaksionit. Ato fillimisht njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohet te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar ose jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivet afatgjata të investimit maten me modelin e koston.

**(d) Aktive afatgjata materiale**

*Njohja dhe matja*

Aktivet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë)*

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat përmbledhëse të tjera në lidhje fitime apo humbje të flukseve të parasë të kualifikuara nga mbulimi për blerjen e pronave dhe paisjeve. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse të funksionalitetit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje.

Në momentin që një nga aktivitetet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve materiale përcaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitetit dhe njihet neto në të ardhura ose humbje të tjera.

*Kostot në vijim*

Kostot për zëvendësimin e një aktiviteti regjistrohen me vlerën kontabël të aktivitetit në rast se është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të, të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

*Amortizimi*

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivitetit ose cdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave bazuar në metodën e vlerës së mbetur sipas normave të mëposhtme për secilën kategori asetesh:

- a) Ndërtesa - 5%
- b) Makineri Paisje - 20%
- c) Mjete transporti - 20%
- d) Paisje informatike - 25%
- e) Paisje zyre - 20%

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Aktivitetet në proces nuk amortizohen. Nëse normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nuk janë të parëndësishme, aktivitetet afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

**(e) Zhvlerësimet e aktiveve**

*Aktivitetet financiare*

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarjeje që ka çuar në zhvlerësimin e tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitetit, dhe kjo ngjarjeje ka efekt negativ në flukset e vlerësuar në të ardhmen nga aktiviteti të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar i skontuar me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave (në humbje ose fitim). Interesi nga aktivitetet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave.

*Aktivitetet jo-financiare*

